Roli i Bankës së Shqipërisë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe afatgjatë të vendit – stabiliteti financiar, një parakusht i domosdoshëm në zhvillimin ekonomik

Gent Sejko

Guvernator
Banka e Shqipërisë

Leksion në Universitetin "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës
Mars 2019

Përmbajtja

1. Roli i Bankës së Shqipërisë në ekonominë dhe sistemin financiar shqiptar
2. Roli dhe funksionet e politikës monetare dhe të stabilitetit financiar
3. Efektet e krizës botërore dhe reagimi i Bankës së Shqipërisë
4. Rezultatet
5. Konkluzione

Roli i Bankës së Shqipërisë në ekonominë dhe sistemin financiar shqiptar

1. **Banka e Shqipërisë si një bankë qendrore moderne udhëhiqet nga parimet e pavarësisë, transparencës dhe llogaridhënies**

2. **Objektivat e Bankës së Shqipërisë:**

   - **Objektivi kryesor: ruajtja e stabilitetit të çmimeve**
   - **Objektiva të tjerë:**
     - Mbikëqyrja dhe ruajtja e stabilitetit financiar
     - Administrimi i një sistemi të sigurt dhe efikas të pagesave
     - Sigurimi i likuiditetit të mjaftueshëm në treg
     - Edukimi financiar i publikut dhe rritja e përfshirjes financiare
   - **Funksion i veçantë:** Roli i autoritetit përgjegjës për ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka

Objektivi dhe instrumentet e politikës monetare: Objektivi

1. **Politika monetare: hartohet dhe zbatohet ekskluzivisht në funksion të përmbushjes së objektivit të ruajtjes së stabilitetit të çmimeve (objektivi kryesor i BSH)**

2. **Pse duhet stabiliteti i çmimeve?**

Stabiliteti i çmimeve, si:

- tregues i shëndetit të ekonomisë (ekuilibrit makroekonomik)
- nxitës i rritjes afatgjatë
- mbrojtës i shtresave në nevojë (parandalues i problemeve sociale)
- parakusht i stabilitetit financiar

Objektivi dhe instrumentet e politikës monetare: Regjimi e Instrumentet

1. **Regjimi dhe kuadri teorik i politikës monetare**
   - Regjimi i politikës monetare: shënjestrimi i inflacionit dhe luhatje e lirë e kursit të këmbimit
2. **Instrumentet e politikës monetare**
   - Operacione të tregut të hapur: instrumenti kryesor repo njëjavore (norma bazë e interesit)
   - Lehtësitë mbështetëse: depozita dhe kredia njëditore
   - Rezerva e detyruar

Objektivi dhe instrumentet e stabilitetit financiar: Objektivi

1. **Stabiliteti financiar: situata kur sistemi financiar kryen funksionet e tij të ndërmjetësimit financiar dhe administrimit të rreziqeve, edhe në kushte financiare të stresuara**

2. **Promovohet nëpërmjet:**

   a. ***politikës makroprudenciale***, e cila ka si objektiv kryesor parandalimin e akumulimit të rreziqeve (sistemike) në sistemin financiar dhe rritjen e rezistencës së tij (Dokumenti i Strategjisë së Politikës Makroprudenciale)

   b. ***bashkërendimit të politikave*** (me politikën monetare dhe mbikëqyrjen mikroprudenciale)

3. **Roli i BSH në stabilitetin financiar është parësor, por jo ekskluziv!**

Objektivi dhe instrumentet e stabilitetit financiar: Instrumentet

Instrumentet e realizimit:

1. Instrumente makroprudenciale. Të tilla mund të jenë:

a. Kryesisht për dimensionin ciklik të rrezikut sistemik:
   (i) instrumente me bazë kapitalin e përgjithshëm;
   (ii) instrumente me bazë kapitalin sektorial dhe aktivet;
   (iii) instrumente të likuiditetit.

b. Kryesisht për dimensionin strukturor të rrezikut sistemik:
   (i) instrumente për mbrojtjen e infrastrukturës me rëndësi sistemike

2. *Instrumente mikroprudenciale*: licencimi, rregullimi, mbikëqyrja (*on-site* dhe *off-site*) e bankave.

Stabiliteti i çmimeve dhe stabiliteti financiar: Sinergjitë

Në afat të gjatë, politika monetare dhe stabiliteti financiar konvergojnë:

1. Stabiliteti i çmimeve është parakusht për stabilitetin financiar.

2. Stabiliteti financiar ndihmon zbatimin e politikës monetare, nëpërmjet ruajtjes së institucioneve financiare të shëndetshme dhe, si rezultat, funksionimit eficient të mekanizmit të transmetimit.

Stabiliteti i çmimeve dhe stabiliteti financiar: Konfliktet

Në afat të shkurtër e të mesëm, mund të ketë konflikte:

1. **Një politikë monetare stimuluese/shtrënguese:**
   - Nxit/dekurajon sasinë dhe cilësinë e ndërmjetësimit financiar, pra edhe oreksin për rrezik;
   - Rrit/ul çmimet e aktiveve (shtëpive dhe aseteve financiare) dhe rrit/ul vlerat e kolateralit, pra mund të çojë në një spirale prociklike të padëshiruar;
   - Dobëson/forcon kursin e këmbimit apo normat e kthimit nga investimet, dhe kështu ndikon potencialisht mbi performancën dhe shëndetin e institucioneve financiare.
2. **Një politikë financiare stimuluese/shtrënguese**
   - Nxit/dekurajon oreksin për rrezik dhe ndikon mekanizmin e transmetimit.

Konteksti ekonomik dhe financiar

1. **Kriza botërore u transmetua në Shqipëri nëpërmjet kanaleve tregtare e financiare:**
   - Kriza botërore solli ngadalësim të ekonomisë dhe rënie të inflacionit
   - Ngadalësimi i ekonomisë solli përkeqësim të kredive me probleme dhe ulje të oreksit për rrezik
2. **Reagimi i politikave ekonomike:**
   - Politika fiskale kishte hapësira të kufizuara (barra e stimulit ra mbi Bankën e Shqipërisë)
   - Politika monetare mori natyrë gjithnjë e më stimuluese
   - Politika makroprudenciale duhej të balanconte: ruajtjen e qëndrueshmërisë së institucioneve financiare me nevojën për të vepruar në mënyrë kundërciklike dhe mbështetur ndërmjetësimin financiar
3. **Reformat strukturore u përshpejtuan, si instrumenti i vetëm për zgjidhjen afatgjatë.**

Politika monetare në Shqipëri

1. **Politika monetare në Shqipëri u bë gjithnjë e më stimuluese, nëpërmjet:**
   - Reduktimit të normës bazë të interesit
   - Injektimit të likuiditetit, me afat më të gjatë dhe kundrejt një game më të gjerë kolaterali
   - Komunikimit më transparent me tregun: përdorimit të *forward guidance*
2. **Politika monetare ndihmoi në:**
   - Reduktimin e kostove të financimit
   - Nxitjen e kredisë në lekë
   - Nxitjen e konsumit, investimeve, rritjes ekonomike dhe lëvizjes së ekonomisë drejt ekuilibrit

Politika makroprudenciale në Shqipëri

Politika makroprudenciale synoi të ekuilibronte përmbushjen e disa objektivave:

1. **Dhënien e stimulit financiar, nëpërmjet ndryshimeve rregullatore që synonin**:
   - Nxitjen e kreditimit, duke ulur peshën e rrezikut në përpjesëtim me rritjen e portofolit të kredisë
   - Lehtësimin e barrës së kreditorëve, duke lehtësuar kushtet për ristrukturimin e kredisë
   - Dekurajimin e investimeve jashtë vendit, duke rritur peshën e rrezikut në përpjesëtim me rritjen e këtyre investimeve
2. **Forcimin e rezistencës së bankave, nëpërmjet ndryshimeve rregullatore që synonin:**
   - Korrektimin dhe përmirësimin e praktikave të huadhënies së bankave
   - Ruajtjen e raporteve të larta të likuiditetit dhe të kapitalizimit
   - Rritjen e përdorimit të monedhës vendase

Ulja e kredive me probleme (KMP)

1. **Ulja e KMP – objektiv i vetëm i Planit Kombëtar të Veprimit**

2. U kryen ndryshime ligjore e rregullative, u rrit fokusi i mbikëqyrjes, me qëllim:
   a. Uljen e stokut të KMP
   b. Uljen e fluksit të KMP

3. Ndryshimet ligjore përfshinin: Kodin e Procedurës Civile, ligjin për falimentimin, ligjin për shërbimin përmbarimor privat.

4. Ndryshimet rregullative përfshinin: fshirjen e kredive të humbura, ristrukturimin e KMP, administrimin e kolateralit të marrë në bilanc nga ekzekutimi, etj.

5. Fokusi i mbikëqyrjes u rrit me kërkesa për raportime specifike, ndryshime në strukturat e riskut të bankave, inspektime të posaçme, *Tirana Approach*.



Koordinimi i politikave në nivel institucional

1. Koordinimi mes politikave në Bankën e Shqipërisë, kryhet përmes Komiteteve të posaçme:

- **KZKPM** ***(Komiteti i Zbatimit dhe Këshillimit të Politikës Monetare)***
- **KKSF** ***(Komiteti Këshillimor i Stabilitetit Financiar)***

Pjesëmarrja e ndërsjellë e funksionarëve nga politika monetare dhe stabiliteti financiar, siguron që bashkërendimi i veprimeve të jetë i duhur.

2. Në nivel ndërinstitucional, çështjet e stabilitetit financiar diskutohen në GKSF (*Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Agjensia e Sigurimit të Depozitave)*

Rezultatet

1. **Ekonomia shqiptare ka përshpejtuar ritmet e rritjes**

2. **Ekuilibrat makroekonomikë janë drejt përmirësimit:**
   - Inflacioni do të lëvizë drejt objektivit
   - Borxhi publik është vënë nën kontroll
   - Bilancet e jashtme mbeten të shëndetshme

3. **Sistemi bankar paraqitet i shëndetshëm:**
   - Treguesit e likuiditetit, kapitalizimit dhe përfitueshmërisë janë sipas parametrave të kërkuar;
   - Kredia me probleme është përgjysmuar, dhe potenciali për rritje të kreditimit është forcuar;
   - Provat e rezistencës japin rezultate pozitive.

Konkluzione

1. **Stabiliteti monetar dhe stabiliteti financiar janë të ndërthurur, ndihmojnë ose dobësojnë njëri-tjetrin – duhet punuar paralelisht në të dy drejtimet!**

2. **Përballimi i pasojave të krizës në Shqipëri kërkoi përdorimin e politikës monetare dhe masave makroprudenciale…**

3. **… por, efektiviteti i tyre u ndikua nga implikimet e ndërsjella që këto instrumente kanë mbi objektivat përkatës.**

4. **Unifikimi i këndvështrimit dhe perspektivës mbi stabilitetin monetar dhe financiar do të përmirësojë rezultatet e punës sonë në të ardhmen.**

5. **Një sistem financiar i qëndrueshëm kontribuon thelbësisht për një rritje të qëndrueshme ekonomike.**

FALEMINDERIT!

POLITIKA MONETARE NË SHQIPËRI

Politika monetare u bë gjithnjë e më stimuluese, nëpërmjet:

- Reduktimit të normës bazë të interesit - nga 6.25% në 2008, në 1.00% në vitin 2018
- Furnizimit të sistemit bankar me likuiditet me afat më të gjatë dhe kundrejt një game më të gjerë kolaterali
- Komunikimit më transparent - orientimit verbal të tregut për qëndrimin e ardhshëm të politikës monetare (*forward guidance*)





POLITIKA MONETARE NË SHQIPËRI

Politika monetare ndihmoi në:









REZULTATET


Aktiviteti ekonomik po përmirësohet gradualisht
9.0
8.0
7.0
6.0
5.0
4.0
3.0
2.0
1.0
0.0
2008 2009 2010 2011 2012 2013 2014 2015 2016 2017 2018
Rritja vjetore e PBB-së (%)


...dhe inflacioni po rritet drejt objektivit
6.0
5.0
4.0
3.0
2.0
1.0
0.0
-1.0
-2.0
-3.0
-4.0
1999 2000 2001 2002 2003 2004 2005 2006 2007 2008 2009 2010 2011 2012 2013 2014 2015 2016 2017 2018


Rritja e borxhit publik ka kufizuar hapësirat për stimul fiskal
80.0
70.0
60.0
50.0
40.0
30.0
20.0
10.0
0.0
2004 2005 2006 2007 2008 2009 2010 2011 2012 2013 2014 2015 2016 2017 2018
Raporti I borxhit publik ndaj PBB (%)


Përmirësimi i ekonomisë dhe masat e koordinuara kanë sjellë ulje të kredive me probleme
25.0
20.0
15.0
10.0
5.0
0.0
2004 2005 2006 2007 2008 2009 2010 2011 2012 2013 2014 2015 2016 2017 2018
Raporti kredi me probleme ndaj kredisë totale (%)

REZULTATET:

SEKTORI BANKAR ËSHTË I MIRËKAPITALIZUAR, LIKUID, FITIMPRURËS DHE I MBËSHTETUR NË BURIMET E BRENDSHME TË FINANCIMIT

BANK OF ALBANIA